



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**QENDRA KOMBËTARE E KULTURËS PËR FËMIJË
SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE TE BRENDSHME**

Nr. _____ prot

Tiranë, më _____, _____ 2024

Relacion për Monitorimin 12-mujori 2023

Qendra Kombëtare e Kulturore për Fëmijë ka për qëllimin edukimin dhe argëtimin e fëmijëve, kultivimin e prirjeve, talenteve, formimin e shprehive dhe shkathtësive. QKKF shërben për njohjen, ruajtjen dhe forcimin e traditës kombëtare, edukon atdhedashurinë, si dhe ndihmon për njohjen e vlerave të kulturës botërore.

Në shërbim të edukimit dhe argëtimit, zhvillimit të lirë të mendimit dhe krijimit, talentit dhe aftësimit, QKKF organizon veprimtari shkollore e ndërshkollore, kombëtare dhe ndërkombëtare si: konkurse, olimpiada, festivale, ekspozita, ekskursione, promovime librash, takime me shkrimtarë, kompozitorë, piktorë, aktorë, etj.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor Gusht 2023 QKKF, TK ka vënë në skenë premierën artistikë "Princesha dhe bizelja magjike", "Roza dhe Fati" dhe "E bija e hënës dhe e diellit" Projektet "Ngjyrat e Nëntorit" dhe "Klipi i vitit të ri" janë organizuar "Ora e përrallës" në kopshtet e qytetit dhe në Spitalin e fëmijëve si dhe janë zhvilluar aktivitete me fëmijët e Qendrës si:

- Ekspozita e skulpturës me fëmijët e Qendrës.
- Aktivitet i MK në bashkëpunim me Trupën asrtistike të TK tek Parku Rinia.
- 3 Koncerte festiv me të gjithë fëmijët e Qendrës me rastin e7-8 Marsin, Ditës së Verës tek Parku Rinia dhe Festën e 1 Qershorit.
- Koncert i TOB "Shqiperia ime" në bashkëpunim me fëmijët e Qendrës në sallën e TOB.
- Ekspozita e pikturës tek Kalaja e Tiranës.
- Koncert me Fëmijët e kursit të këngës/muzikës të QKKF
- Koncert festiv me fëmijët e kursit të këngës dhe muzikës të QKKF-skena e T.Kukullave.
- Ekspozitë me fëmijët e kursit të pikturës tek Kalaja e Tiranës dhe në Galerinë e Arteve.
- Festivali i kërcimit tek parku i Liqenit
- Ekspozite me femijet e kursit te kostumografisë QKKF etj.
- Ekspozita e skulpturës me fëmijët e Qendrës.
- Aktivitet i MK në bashkëpunim me Trupën asrtistike të TK tek Parku Rinia.
- 3 Koncerte festiv me të gjithë fëmijët e Qendrës me rastin e7-8 Marsin, Ditës së Verës tek Parku Rinia dhe Festën e 1 Qershorit.
- Koncert i TOB "Shqiperia ime" në bashkëpunim me femijët e Qendrës në sallën e TOB.
- Ekspozita e pikturës tek Kalaja e Tiranës.
- Aktivitet "trashëgmimia kulturore" tek Muzeu Kombëtar etj

Fondi buxhetore i planifikuara për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është realizuar në masën 94.26 % e paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme, sipas artikujve buxhetorë dhe nivelit të realizimit të tyre në vlerë dhe në përqindje:

NR.	Emertimi i Shpenzimit	Plani Buxhetor	Fakti Buxhetor	% e realizimit te Buxhetit
1	Shpenzime Paga	32,470,175	32,455,893	99.96
2	Shpenzime sigurime shoqerore	5,410,626	5,316,268	98.26
3	Shpenzime operative	3,731,850	3,727,624	99.89
4	Shpenzime Cilesi Artistike	2,468,150	2,409,750	97.63
5	Shpenzimet operative nga te ardhurat	2,500,000	200,700	8.03
	Totali	46,580,801	44,110,235	94.70

Fondi i pagave është realizuar në masën 99.96 % dhe sigurimeve shoqërore në masën 98.26 % Numri i punonjësve të QKKF-së për 12 mujorin e vitit 2023 ka qënë 29 punonjës nga 30 që janë në organikë dhe një punonjës me kontratë të përkohshme mbi organikë.

Shpenzimet operative nga të ardhurat janë realizuar në masën 8.03 % e cila ka ndikuar edhe në realizimin e shpenzimeve totale në masën 94.70%.

QKKF realizon të ardhura nga shitja e biletave për shfaqjet e Teatrit të Kukullave dhe tarifa e regjistrimit të fëmijëve në kurset artistike nga të cilat 70% derdhen në buxhetin e shtetit dhe vetëm 30% kalojnë për llogari të institucionit. Këto të ardhura për vitin 2023 janë realizuar në shumë 600,000 lekë.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar të ardhurat e realizuara nga institucioni për periudhën Janar-Dhjetor 2023

Pershkrimi I te ardhurave janar-dhjetor 2023	Arketime mujore	Totali Arketimeve	Pjesa e instituc.	Rritje autorizuar	Derdhur ne buxhet
Te ardhura nga Qiraja	452,000	5,591,590			5,591,590
Te ardhura nga Biletat	153,500	1,522,400	456,720	290,000	1,065,680
Te ardhura nga Kurset	15,000	484,555	145,367	110,000	339,189
Te ardhura nga Sponsoriz			-		-
Totali	620,500	7,598,545	602,087	400,000	6,996,459

Të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e Lulishtes së Kinema Milenium të cilat për vitin 2023 në shumën 5.6 miloin lekë, janë derdhur 100% në buxhetin e shtetit.

Të ndodhur në kushtet që Teatri i Kukullave është në rikonstruksion, QKKF nuk mund të realizoj më të ardhura nga dhënia me qira e ambienteve dhe sallës së teatrit të kukullave nga të cilat 90% kalonin në llogarinë e institucionit.

Sa më sipër sqarojmë se shuma prej 2.5 milion lekë e parashikuar në buxhetin e vitit 2023 për tu realizuar nga të ardhurat e Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë është jashtë mundësive të institucionit edhe për faktin që çmimi i biletës për shfaqjet e teatrit të kukullave është 100 lekë dhe tarifa vjetore për kurset artistike është 1,500 lekë.

Treguesit e performancës:

I. Produkti i I-rë Numri i shfaqjeve teatrale të dhëna

QKKF ka bërë përpjekjet maksimale për të realizuar sa më shumë shfaqje teatrale si brenda Tiranës ashtu edhe nëpër qytete të tjera pasi për shkak të kohë zgjatjes së pandemisë kërkesat e fëmijëve për shfaqjet teatrale kanë ardhur gjithnjë e në rritje. Për vitin 2023 ky tregues është realizuar 82%, nga 250 shfaqje të planifikuara për tu shfaqur gjatë vitit 2023 janë dhënë vetëm 204.

Arsyeja kryesore e mosrealizimit të këtij treguesi pasi Teatri i Kukullave është në rikonstruksion dhe shfaqjet jepen në sallë e Liceut artistik vetëm ditën e shtunë dhe të diel duke respektuar kalendarin artistik të Liceut Artistik.

II. Produkti i II-të Numri i projekteve dhe aktiviteteve artistike të realizuara

Treguesi i Produktit II është realizuar 115 %. Krahas 5 projekteve artistike të realizuara gjatë vitit janë organizuar shumë aktivitete artistike me fëmijët e Qendrës si për 7-8 Marsin, Dita e Verës, 1 Qershori tek Parku Rinia dhe Sheshi Skenderbej si dhe ekspozita me piktura dhe kostumografi të zhvilluara gjatë gjithë vitit tek Kalaja e Tiranës, Muzeu Kombëtar dhe Galeria e Arteve si dhe Koncerte festive me fëmijët e kursit të baletit dhe të muzikës.

III. Produkti i III-të Numri i fëmijëve të regjistruar në kurset artistike

Ky tregues është realizuar 129 % edhe pse aktivitetet me fëmijët e qendrës kanë ardhur duke u rritur gjatë vitit 2023. Nga 250 fëmijë të planifikuar për tu regjistruar gjatë vitit 2023 janë regjistruar dhe frekuentojnë kurset artistike 323 fëmijë.

Kërkesat e larta të fëmijëve për të ndjekur kurset artistike të Qendrës si dhe promovimi i tyre në faqet zyrtare të institucionit websit dhe facebook si dhe promovimi i tyre në kopshtet dhe shkollat e kryeqytetit kanë ndikuar në tejkalimin e objektivave për këtë komponent.

PËRGJ. SEKTORIT TË FINANCËS
ADELINA AVDULAJ

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
AGIM BAJKO